

VENDIM
Nr.943, datë 26.8.2009

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM,
TË KOMUNËS HELMËS TË QARKUT TË TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të komunës Helmës, të qarkut të Tiranës, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Helmës të qarkut të Tiranës, miratuar me vendimin nr.877, datë 12.12.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Helmës, të qarkut të Tiranës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Helmës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Helmës

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
1-12	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
13-16	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
17	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën administrative.	Në pronësi
18-32	Varreza publike	Në pronësi
321-658	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
95-99,117,123,124,126-128,135,145-148,152-155,158,162	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
33-41	Prona që përdoren në fushën e strehimit dhe mbrojtjes civile.	Në pronësi
46-78,80,81,84-94,100-116,118,122,125,129-134,136-144,149-151,156,157,159-161,163-177.	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik.	Në pronësi
178,179,181-184,186-189,191-194,196-199,201,202,204-206,208-210,212-215,217-219	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim

180,185,190,200,203,207,211,216,220,223,224,226,227,229,233,236,239,242,245,247,250-252	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka joproduktive).	Në përdorim
690-702	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve.	Në pronësi